

AKT EKSPERTIMI KONTABEL



MBI VLERESIMIN E KAPITALIT SHTETEROR DHE SIPERFAQES TRUALLIT

TE SHOQERISE SH.P.K. SUPERBETON SARANDE

Me cilesine e ekspertit kontabel ligjor te autorizuar nga A.K.Privatizimi dhe nga SH.P.K. Superbeton Sarande, me prokure te rregullt une Leonidha Foti, kryejta ekspertimin kontabel te llogarive te bilancit te SH.P.K. Superbeton Sarande per aktivitetin financiar te periudhes 1.1.1995-31.10.1995

Ekspertimi u krye per nje periudhe kohe, nga data 1.11.1995 deri me 13.11.1995

Sipas renditjes ceshtjet e trajtuara ne ekspertize jane:

I - Kontributet ne kapitalin e shoqerise

Sipas aktit te themelimit te shoqerise te depozituar ne Regjistrin Tregtar Tirane, me vendimin e Gjykates Tirane n. 447 dt. 14.1.1994, kapitali i nenshkruar eshte 402.000 dollare USD (e konvertuar me kursin 97.5 lek) dhe ne leke 39195000 leke, e detajuar sipas ortakeve.

- | | |
|-------------------|-------------------------------|
| 1. Pala shqiptare | 181000 USD ose 17.647500 leke |
| 2. Pala greke | 221000 USD ose 21.547500 leke |

Ne baze te kontributeve te nenshkruara pala shqiptare perfaqeson 45 per qind te kapitalit dhe pala greke 55 per qind te kapitalit.

Sipas verifikimit te kryer nga ana ime, dhe mbi bazen e bilancit te shoqerise kontributet faktike ne kapital jane:

- | | |
|------------------|-----------------------------|
| - Pala shqiptare | 181.000 ose 17.647.500 leke |
| - Pala greke | 165.000 ose 16.087.500 leke |

Duke marre parasysh V.K.M. nr. 288 dt. 5.6.1995 si dhe udhezimet e A.K.P. dhe Ministrise se Financave Nr. 10, dt. 10.7.1995 dhe nr. 10/2 dt. 18.10.1995, meqenese ne kapitalin shqiptar, toka eshte me vlere 3994.000 leke duhet per efekt privatizimi te zhvishet nga kontributi ne kapital. Ne kushte kapitali faktik (pa token) me dt. 31.10.1995 eshte/

I. Kapitali faktik shoqerise 29.741.000

- | | |
|-------------------|------------|
| 1. Pala shqiptare | 13.653.500 |
| 2. Pala greke | 16.087.500 |

Mbi baze te kontributeve faktike (pa token) raportet ne perqindje jane:

- | | |
|-------------------|-------------|
| 1. Pala shqiptare | 46 per qind |
| 2. Pala greke | 54 per qind |

II - Inventarizimet

Llogarite e inventarit ne bilanc jane te rakorduara. Per Llogarite e



Gjendjeve te inventarit dhe ne proces eshte kryer inventari fizik me 31.10.1995 kurse per Aktivet e Qendrueshme te p̄ivatizuara u krye dhe u rakordua inventari kontabel.

Gjendja e arkës ne bilanc eshte e rakorduar me inventarin e dt. 31.10.1995

Gjendja e bankes edhe e rakorduar me ekstraktin e bankes me dt.31.10.1995

Vleresimi i gjendjeve te inventarit eshte kryer konform ligjit "Per kontabilitetin", pra me koston faktike te blerjes ose prodhimit.

III - Rezultati i shoqerise

Per vitin 1995 shoqeron (deri me 31.10.1995) rezulton me humbje per 5.168.740.40 leke. Llogaritja e rezultatit ekonomik eshte kryer konform rregullave kontabike te percaktuara ne "Ligjin per kontabilitetin"

Duke analizuar dhe periudhen e mepasshme nga dita e themelimit shoqeria ka nje humje ne shumen 5.448.115.15 leke, nga e cila

- Nga vitet e meparshme 279374.75 leke

- Nga viti 1995 (deri me 31.10.1995) 5.168.740 leke

Pjesa e humbjes qe i takon cdo ortakut mbi bazen e kontributeve faktike duhet te jete:

-Pala shqiptare 5.448.115.15 x 46 per qind=2.506.133 lek

-Pala greke 5.448.115.15 x 54 per qind=2.941.982.15 leke

IV - Debi kredite

Detyrimisht debitore dhe kreditore u verifikuan dhe jane te rakorduara. Shoqeria me dt. 31.10.1995 ka ne bilanc

1. Detyrime debitore (pa detyrimin epales greke per kapitalin 1.200.473 leke.

2. Detyrime kreditore 7.993.109 leke.

Mbi bazen e kontributeve faktike ne kapital (pa token) shuma e detyrimeve per secilin ortak eshte:

1. Detyrime debitore 1.200.473 leke
- Pala shqiptare 46 per qind 552.217 leke
- Pala greke 54 per qind 648.255 leke

2. Detyrimet kreditore 7.993.109
- Pala shqiptare 46 per qind 3.676.830 leke
- Pala greke 54 per qind 4.316.279



Vleresimi i tokes per privatizim

Mbeshtetur ne V.K.M. N.288 dt.5.6.1995 ku thuhet qe toka te vihet per shitje shoqerise u krye vleresimii tokes nga Keshilli Rrethit Sarande (seksioni i finances, Urbanistikes Ligjore) sipas kriterëve te percaktuara ne V.K.M. Nr. 312 dt. 6.1994.

95.512 m 3

-Siperfaqja e truallit te shoqerise sipas gentplaneve eshte

- Vleresimi total truallit shoqerise 23.445.760 leke. Bashkengjitur akt ekspertizes, bilancit, eshte dhe akt vleresimi i tokes.

Per sa me siper u krye ekspertiza nga ana ime, e cila i bashkengjitet bilancit te shoqerise Superbeton, Sarande, per efekt privatizimi.

EKSPERTI KONTABEL

Leonidha FOTI

Republika e Shqipërisë
Noteria - Sarande
NR 5455 Rep

Vertetuar

7 SEP 1996

Vertetohet me ne shkrimin e
Leonidha Fotit me akt _____



Noteri
Thoma Zoro